

VENDIM
Nr. 18, datë 21.1.2000

PËR ZOTËRIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË "BANKA KOMBËTARE TREGTARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8433, datë 21.12.1998, "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të vendimit nr. 218, datë 23.4.1999, të Këshillit të Ministrave, pas negociatave të zhvilluara me investitorët, zotërimi i aksioneve të shoqërisë "Banka Kombëtare Tregtare" të jetë si vijon:

- Kent Bank të zotërojë 60 për qind + 2 aksione;
 - Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) të zotërojë 20 për qind- 1 aksion;
 - Koorporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) të zotërojë 20 për qind – 1 aksion.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta